



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX:: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

**NEON RS ANTI MOLD
(PLASTIKO ANTIMYK)
BOJE KUNDRA MYKUT
Skedë Teknike**

PËRSHKRIMI: RS ANTI MOLD është një bojë e shkëlqyer kundra mykut,e bardhë e pergatitur nga një emulsion i tipit “polimer (PVA-VEOVA) në ujë” e destinuar për lyerje muri të brendshëm dhe të jashtëm , që përveç rezinave dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushësa, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, polisiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, si edhe një përbërës të fortë antimyku, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, dhe në kushte normale, boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një cipë plastike, e cila ka rezistencë shumë të mirë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri ndaj dritës dhe ujit.
Mbas dy javësh nga aplikimi sipërfaqja mund të lahet me ujë dhe sapun.

FUSHA E PËRDORIMIT: RS ANTI MOLD është e përdorshme në mjedise të brendshme (mure) si dhe për mjedise të jashtme, për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni, për ti mbrojtur ato nga myku.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra), dhe sidomos nga myku që mund të ketë sipërfaqja që do të bojatiset. Rekomandohet paraprakisht lyerja me astar AN – 501 nëse ambjenti që do të bojatiset është jashtë. Ndërsa nëse ambjenti që do të bojatiset është brenda rekomandohet astar PN – 301 ose PN – 101.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar RS ANTI MOLD. Presim anët e sipërfaqes dhe kalojmë dorën e parë me bojë të holluar me 10% ujë. Kur prerjet dhe dora e parë të jenë tharë, kalojmë dorën e dytë të holluar po me 10% ujë. Në kushte normale sipërfaqja e lyer thahet pas 4 – 6 orë. Është i rezistueshëm në kushte të vështira atmosferike dhe në mënyrë elastike ndjek sipërfaqen ku aplikohet. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

NGJYRIMI: RS ANTI MOLD është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyruese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyruese NEON RS COLOR PAINT.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5⁰C. Pas përfundimit të lyerjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....E bardhë
- Imtësia.....10 – 30 µm
- Viskoziteti (30% ujë) Deep Cup 4.....35 – 45 sek
- Densiteti.....1.57 – 1.63 g/ml
- Fuqia mbuluese për dy duar0.6 L për 3 – 4 m²
- Mbetja e thatë.....≤ 65 %
- Koha e tharjes.....3 - 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat me bazë ujore të “NEON sh.a” kanë përbërës që nuk klasifikohen si të rrezikshëm mbështetur në Direktivën 1999/45/EC. Megjithatë kontakti me acidet dhe në temperatura mbi 800⁰C, bën që të çlirohet dioksid karboni.

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kova plastike 0.75L, 3L, dhe 9L.